



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.8.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Jusuf Kryeziu, (udhëheqës i ekipit) dhe Nora Rashiti Nishefci (anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
5 Qeverisja e mirë.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	32
Shtojca III: Letër konfirmimi	39

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Infrastrukturës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë së Infrastrukturës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Kualifikuar me Theksim të çështjes

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale *përveç çështjeve në vijim*:

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit, buxheti fillestar 35,400,000 dhe buxheti final 1,300,000 nga huamarrjet, gjithashtu buxheti fillestar 51,400,000 dhe buxheti final 1,000,000 nga AKP nuk do duhej të prezantohen.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin që nga kategoria e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar shpenzimet (kontratat) e mirëmbajtjes së rrugëve në vlerë prej 760,014€, për projekte të cilat nuk e përmbushin përkufizimin për të qenë "kapitale" por, për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbimeve, gjithashtu pasuritë janë mbivlerësuar për të njëjtën vlerë.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Infrastrukturës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e MI-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Infrastrukturës në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Te neni 14 i PVF-ve - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit, buxheti fillestar 35,400,000 dhe buxheti final 1,300,000 nga huamarrjet, gjithashtu buxheti fillestar 51,400,000 dhe buxheti final 1,000,000 nga AKP nuk është dashur të prezantohen. Buxheti i prezantuar nga huamarrja dhe AKP ishte buxhet i planifikuar për shpenzim e jo buxhet i planifikuar për inkasim.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se: një pjesë e shpenzimeve janë buxhetuar dhe realizuar/shpenzuar gabimisht në kategoritë joadekuate, si dhe janë mbivlerësuar pasuritë si:

- **Keq klasifikimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale.** Në kategorinë e investimeve kapitale, për mostrat në vlerë totale prej 760,014€ kemi vërejtur që janë kryer pagesa për mirëmbajtje të rrugëve. Këto pagesa nuk e përmbushin kriterin për me qenë 'kapitale' si monitorimi dhe inspektimi, largimi i vegetacionit, prerja e barit, largimi i ujërave, furnizimi me kripë, etj. Këto shërbime ishin planifikuar nga MI dhe buxhetuar nga Ministria e Financave duke ndikuar që të mbivlerësohen investimet kapitale dhe të nënvlerësohen mallra dhe shërbimet.
- **Mbivlerësim i Pasurive.** Pasuritë janë mbivlerësuar për 760,014€, duke përfshirë blerjen e mallrave dhe shërbimeve për këtë vlerë.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Gjatë auditimit, MI kishte vështirësi që me kohë në disa raste të sjellë dokumentacionin zyrtar të saj. Për më tepër, në një rast/mostër për auditim të procedurave të prokurimit, në dosje ka munguar një pjesë e dosjes/dokumentacionit.

Siguria e dobët në ruajtjen e dokumentacionit dhe mungesa e dokumentacionit të plotë për auditim, është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik që specifikon se Autoriteti kontraktues të mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në dhënien e kontratës ose konkursit të projektimit. Përderisa rregullorja e MAP nr. 01/2015 specifikon se në përgjithësi dokumentet e prokurimit duhet të ruhen 7 vite ndërsa dosjet e tenderit 10 vite. Mungesa e dokumentacionit përveç që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi po ashtu e rrezikon kufizimin e fushëveprimit të punës/auditimit dhe jep sinjal rreth mungesës së transparencës së procesit.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MI-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të MI-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MI-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Deklarata e bërë nga menaxhmenti i MI-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF nuk mund të konsiderohet e saktë, pasi ekzistojnë gabime që kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipërpërmendura jepet rekomandimi:

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikimin e opionionit. Përgatitja e PFV-ve t'i nënshtrohet kontrolleve dhe rishikimit të duhur më qëllim që të mos përsëritën gabimet në prezantimin e huamarrjeve dhe të hyrave nga AKP;
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të analizoj shkaqet e theksimit të çështjes dhe të siguroj/ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe të siguroj prezantim real të pasurive të Ministrisë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MI në vazhdimësi ka treguar gatishmëri në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara. Rezultatet tona të auditimit kanë nxjerrë në pah se MI ka vendosur kontrolle adekuate në shumicën e aktiviteteve operative dhe financiare.

Megjithatë, kontrollet në kategorinë e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve, menaxhimit të pasurive dhe obligimeve të papaguara duhet të përmirësohen. Ndërsa kontrollet në fushën e menaxhimit të të hyrave janë funksionale dhe po zbatohen në mënyrë efektive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi/burimet e fondeve	Buxheti Fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Totali fondeve:	305,581,540	238,515,438	234,379,055	213,025,341	166,658,872
Granti i Qeverisë -Buxheti	192,581,540	236,215,438	234,309,830	213,025,341	166,658,872
Klauzola e Investimeve	26,200,000	2,000,000	-	-	-
Te hyrat nga AKP	77,600,000	-	-	-	-
Financimi nga Huamarrjet	9,200,000	300,000	69,225	-	-

Buxheti final ishte më i ulët se buxheti fillestar për 67,066,102€. Në vitin 2017, MI ka përdorur 98% të buxhetit final ose 234,379,055€, ky realizim krahasuar me vitin 2016 është për 9% më i lartë. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	305,581,540	238,515,438	234,379,055	213,025,341	166,658,872
Pagat dhe Mëditjet	1,718,796	1,756,796	1,743,492	1,716,303	1,509,799
Mallrat dhe Shërbimet	5,903,323	6,127,733	5,776,727	5,883,302	5,794,374
Shërbimet komunale	375,190	253,265	137,337	153,637	180,489
Subvencionet dhe Transferet	1,443,814	1,620,044	1,442,658	832,678	1,012,234
Investimet Kapitale	296,140,417	228,757,600	225,278,842	204,439,421	158,161,976

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është rritur për 38,000€, ndërsa janë shpenzuar 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar është rritur për 224,410€, prej tyre 102,485€ janë financime të ndara nga huamarrjet dhe 121,925€ nga buxheti i Kosovës. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar rreth 94%;
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 121,925€. Buxheti final është shpenzuar rreth 54%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur për 176,230€, nga buxheti i Kosovës. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar rreth 89%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 67,382,817€ prej tyre vlera prej 9,002,485€ ishte zvogëluar financimi nga huamarrja, vlera prej 24,200,000€ ishte zvogëluar nga klauzola e investimeve kapitale dhe vlera prej 77,600,000€ ishte zvogëluar nga të hyrat nga AKP-ja. Përderisa nga buxheti i Kosovës është rritur për 43,419,668€. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 98%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Ministria e Infrastrukturës, në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat e planifikuara për vitin 2017 janë 1,785,000€, ndërsa realizimi i tyre ishte në vlerë prej 2,501,388€. Këto të hyra mbledhen kryesisht nga lëshimi i patentë shoferëve, ripërtëritja e licencave, aplikimi për licenca vendore dhe transport etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat	1,785,000	1,785,000	2,501,388	2,510,869	1,883,850
Totali	1,785,000	1,785,000	2,501,388	2,510,869	1,883,850

Të hyrat e vitit 2017 janë po thuajse të njëjta me ato të vitit 2016. MI këto të hyra i inkason për buxhetin e Kosovës. Nga testimet tona nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrolllet kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e MI-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar afro 99.24% të buxhetit final. Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë.

Çështja 3 - Mbajtje e pozitës - Ushtrues detyre më gjatë se tre muaj

E gjetura Sipas nenit 30 të LSHC 03/L-149: nëpunësit civilë, me urdhër nga eprori, janë të detyruar që përkohësisht ta zëvendësojnë një koleg i cili mungon ose ta plotësojnë një vend të lirë të punës, nëse veprimtaria e zakonshme e institucionit do të pengohet nga mungesa e nëpunësit civil. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Në MI, në dy raste kemi vërejtur që nëpunësit civil (udhëheqës divizioni) kanë mbajtur pozitën ushtrues detyre më tepër se tre muaj (18 përkatësisht 23 muaj).

Rreziku Mbajtja e pozitave me UD në periudha të gjata kohore duke i tejkaluar afatet e përcaktuara ligjore, rrit rrezikun për menaxhim efikas, me përgjegjësi dhe kompetencë të plotë.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë zgjidhje të qëndrueshme për pozitat ushtrues detyre dhe pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore.

3.4 Menaxhimi i personelit

Ministria është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të personelit në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil. Ne kemi testuar një numër të mostrave për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me legjislacionin përkatës.

Çështja 4 – Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri në punë dhe pa realizim të detyrave

- E gjetura** Rregullorja nr. 05/2010 e orarit të punës, neni 4 pika 3 thuhet: orari i punës fillon në orën 8:00 dhe përfundon në orën 16:00 përveç nëse rregullohet ndryshe nga organizata. Gjithashtu neni 7 vijueshmëria në punë: gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose regjistrin elektronik si dhe mospërfillja e orarit të punës paraqet shkelje disiplinore. Në një rast kemi vërejtur që MI nuk kishte dëshmi për vijueshmërinë në punë për një zyrtar. I njëjti asnjëherë nuk figuron në regjistrin e ardhje vajtjeve në punë gjatë vitit 2017 ndërsa kompensimi vjetor për këtë të punësuar ishte 4,564€. Gjithashtu nuk ka dëshmi për realizimin/kryerjen e punëve në përputhje me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive që është ngarkuar në MI. Në listën e pranuar nga zyrtarët përgjegjës të MI-së, vërehet se ekzistojnë edhe 31 punonjës/raste tjera të ngjashme, ku të gjithë i përkasin komunitetit të minoriteteve.
- Rreziku** Mos vijueshmëria në punë dhe mos realizimi i detyrave dhe përgjegjësive në përputhje me kontratën e punës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe paraqet shembull jo të mirë punonjësit tjerë. Kompensimi i tillë i zyrtarëve e dëmton buxhetin dhe reputacionin e organizatës në përgjithësi, gjithashtu e rrit rrezikun që organizata të dështoj në realizimin e objektivave të saja.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj kontrole adekuat në fushën e personelit, të ndërmerren hapat e duhur për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe të siguroj menaxhim efikas dhe efektiv të organizatës në drejtim të realizimit të objektivave të saj.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 6,380,998€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,914,063€. Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 5,776,727€ dhe për shërbime komunale 137,337€. Në këtë kategori ishin shpenzuar rreth 93% të buxhetit final (ref: tabela nr.2). Ne kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe si rezultat i ekzaminimit doli që:

Çështja 5 - Keq-klasifikimi i shpenzimit brenda kategorisë së mallra dhe shërbimeve

E gjetura Sipas Rregullës së Thesarit 02/2009 për shpenzimin e parasë publike, neni 24 pika 4 (Inicimi i shpenzimeve), shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, në pajtim me udhëzimet administrative për klasifikimin ekonomik të lëshuar nga Thesari, sipas strukturës së planit kontabël të vendosur në SIMFK. Në tri raste në total prej 65,204€ kemi vërejtur keq-klasifikim të shpenzimeve brenda kategorisë së mallra dhe shërbimeve. Ato janë:

- Pagesa në vlerë prej 53,910€ për anëtarësinë vjetore/kontributet e MI-së për SEETO (South East Europe Transport Observatory), është paguar nga kodi ekonomik 14030 (Mirëmbajtja e auto rrugëve). Kjo ka ndodhur në mungesë të mjeteve nga kodet tjera pasi pagesa do të duhej të realizohet nga shpenzimet për anëtarësim - kodi (13480);
- Pagesa në vlerë prej 155€ është bërë për pagesën e tatimit në qira për objektin në Mitrovicë nga kodi ekonomik 14110 (qiraja për ndërtesa), ndërsa do të duhej të ekzekutohet nga kodi ekonomik 14510 (pagesa e tatimit në qira); dhe
- Pagesa në vlerë prej 11,139€ për fletat e sondazheve dhe fletëpalosjeve për Komunën e Prishtinës, Gjilanit dhe Mitrovicës është bërë nga kodi ekonomik 13460 (Shërbime kontraktuese tjera). Pagesa është dashur të ekzekutohet nga kodi ekonomik 14230 (shpenzimet e informimit publik).

Rreziku Klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve shkakton, mbivlerësim dhe nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe një prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve, të siguroj klasifikimin e duhur të tyre për një pasqyrim të drejtë dhe të saktë financiar.

Çështja 6 - Ndarje e procedurave me natyrë të njëjtë me blerje minimale

E gjetura Sipas *Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik* pika 48.2, në llogaritjen e vlerës së kontratës për përdorimin e procedurës së vlerës minimale, autoriteti kontraktues do t'i marrë parasysh vetëm një grup të mallrave, shërbimeve apo punëve të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen së bashku dhe të cilat nuk duhet të ndahen me qëllim të përdorimit të një procedure të tillë. Ndërsa pika 48.1 thotë që Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përlogaritur e të cilës është më pak se 1,000€.

Zyra e prokurimit kishte aplikuar procedura/kontrata me vlerë minimale, duke u furnizuar dhe kryer disa herë gjatë vitit për të njëjtat shërbime/artikuj: tre herë furnizim me klimë, tre herë furnizim me kompjuter, pesë herë furnizim me toner, dy herë furnizim me letër të bardhë dhe dy herë është bërë furnizimi me karrige statike.

Te Furnizimi për klimë është tejkalar shuma prej 1,000€, duke kontraktuar shërbimet në vlerë prej 1,200€.

Rreziku Aplikimi i kontratave të ndara për të njëjtin mall/shërbim nuk është efikas, ndikon në eliminimin e konkurrencës, mund të sjellë oferta më të larta si dhe shkakton kosto shtesë për Ministrinë.

Rekomandimi 6 Ministri duhet t'i forcoj kontrollet në zyrën e prokurimit dhe njësive kërkuese, në mënyrë që për furnizimet e njëjta të aplikohet procedurë adekuate/e hapur e prokurimit dhe kontraktimit.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,620,044€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 1,442,658€ apo rreth 89% të buxhetit final (ref: tabela nr.2). MI subvencionon transportin publik hekurudhor (Mbështetja dhe Financimi i biletave të udhëtarëve në linjat hekurudhore funksionale dhe transportin publik rrugor (Financimi i transportit tokësor rrugor nëpër linjat e paqëndrueshme të transportit rrugor).

Ne kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë nga të cilat nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 228,757,600€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 225,278,842€, ose 98%. Në këtë kategori kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Si rezultat i ekzaminimit të këtyre mostrave doli që:

Çështja 7 - Dobësi në menaxhimin e projekteve në bashkëfinancim me Komunat përkatëse

E gjetura Ministria e Infrastrukturës ka një numër të konsiderueshëm të projekteve infrastrukturore të cilat i bashkë-financon me Komunat përkatëse. Komuna obligohet që projektet t'i zhvilloj në pajtim me rregullat e prokurimit publik dhe ligjin mbi menaxhimin e financave publike, ndërsa MI i siguron mjetet për projektet dhe i realizon pagesat për financimin e projekteve në pajtim me realizimin e punimeve sipas kushteve të kontratës.

Sipas nenit 3 pika 3 të MiM "MI cakton një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projekteve nga fillimi deri në përfundim të kontratës".

Në 12 raste të testuara në vlerë 628,419€ kemi vërejtur se situacionet nuk janë nënshkruar nga menaxheri i projektit nga ana e Ministrisë. Menaxherët e projekteve kanë lëshuar vetëm certifikatën për pagesë e cila nuk konfirmon se janë bërë pranimet për sasinë dhe kualitetin e punimeve. Në këto raste ne nuk kemi mundur të marrim siguri se janë bërë verifikimet e duhura për punët e kryera nga ana e Ministrisë.

Rreziku Mungesa e monitorimit adekuat nga ana e Ministrisë për projektet të cilat i financon rrezikon devijimin e projektit si dhe rrit rrezikun e kryerjes së pagesave potencialisht të parregullta.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë të projekteve në bashkëfinancim dhe nëpërmjet departamentit të Menaxhimit të Rrugëve të forcoj kontrollet në pranimin e shërbimeve nga organet e vendosura mbikëqyrëse.

Çështja 8 - Keq-klasifikimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale dhe mangësi në procesin e pranimit

E gjetura Në 10 raste në kategorinë e investimeve kapitale, në vlerë prej 738,529€, janë kryer pagesa për mirëmbajtjen e rrugëve, mirëpo këto pagesa nuk e përmbushin plotësisht kriterin për klasifikim në kapitale. Këto pagesa përmbajnë elemente të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve si (monitorimi dhe inspektimi, largimi i vegjetacionit, prerja e barit, largimi i ujërave, furnizimi me kripë, etj), si dhe elemente të investimeve kapitale si p.sh. (gërmimi i dheut, asfaltimi i dëmtimeve me asfalt/beton, betonimi i pilotave, armimi i murit mbrojtës etj). Në kuadër të këtyre pagesave, ne nuk kemi mundur të nxjerrim vlerën e saktë të keq klasifikimit (shpenzimeve të cilat do të duhej të paguheshin nga mallra dhe shërbimet), pasi që situacionet e pranuar nga menaxherët e pasqyrojnë punën totale nga lidhja e kontratës (viti 2014) e deri në datën e pagesës, e jo situacionin/punën e cila ndërlidhet me pagesë aktuale. Pagesat ishin bërë nga kodi ekonomik 31210 (ndërtimi i auto-rrugëve) dhe 31220 (ndërtimi i rrugëve regjionale). Këto shërbime ishin planifikuar nga MI dhe buxhetuar nga Ministria e Financave.

Rreziku Mungesa e pranimit të punëve/situacioneve të qarta rreth kryerjes së punëve vështirëson klasifikimin e shpenzimeve (mallra shërbime në raport me investimet). Ndërsa shpenzimi/klasifikimi jo-korrekt i mjeteve nga investimet kapitale për mallra dhe shërbime ndikon në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e kategorisë së mallra dhe shërbimeve. Kjo zvogëlon efektivitetin e kontrollit buxhetor dhe shkakton keq klasifikime në PFV.

Rekomandimi 8 Ministri në bashkëpunim me ZKF dhe Departamentin për menaxhimin e rrugëve duhet të identifikojnë masat që duhen të ndërmerren në mënyrë që pranimet e situacioneve të shpalosin saktë se cila vlerë në kuadër të pagesës reflekton mirëmbajtjen e cila investimet kapitale. Po ashtu, në bashkëpunim me MF mjetet të klasifikohen/buxhetohen saktë në kategori ekonomike të cilat kanë ndikim material në PFV-të e organizatës.

Çështja 9 - Hyrja në obligime kontraktuale pa mbulueshmëri të mjaftueshme financiare

E gjetura Sipas *Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik* neni 7, pika 7.1 AK do të inicioi një aktivitet të prokurimit vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave, pse saktësisht nevojitet prokurimi. Vlerësimi do të përfshijë: indikacion të qartë të punëve, shërbimeve ose furnizimeve që kërkohen; vlera e parashikuar e punëve, shërbimeve ose furnizimeve; si dhe informata tjera.

Kontrata/projekti “Ndërtimi i rrugës Dragash-Shishtavec pika kufitare me Shqipërinë Segmenti Kryqëzimi me rrugën nacionale R113 deri tek pika kufitare Borje Jazhince” ishte kontraktuar në vlerë prej 199,877€, ndërsa sipas deklaratës së disponueshmërisë, mjetet ishin buxhetuar në vlerë prej 50,000€.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme e rrit rrezikun e krijimit të vonesave të zbatimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të forcoj kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e tij.

Çështja 10 - Parregullsi në njoftimin për dhënie të kontratës

E gjetura Sipas LPP neni 41 (njoftimi mbi dhënien e kontratës) nëse autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara ose të negociuara, ose procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas dhënies së kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin mbi dhënien e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji.

Tek kontrata “Ndërtimi i udhëkryqit në fshatin Xërxë” prej 189,891€ me nr. të prokurimit MI 17 039 521, Zyra e prokurimit nuk e kishte bërë njoftimin për dhënie të kontratës të cilën duhet ta dorëzoj në KRPP, mirëpo vetëm ju kishte dërguar letër standarde tenderuesve.

Rreziku Mungesa e njoftimit mbi dhënien e kontratës tregon dobësi në procesin e prokurimit si dhe rrezikon transparencën e aktiviteteve rreth projektit.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të siguroj kontrolle në fushën e prokurimit duke përcaktuar shkaqet e mos përmbushjes së kërkesave ligjore në prokurimin e zhvilluar, më qëllim eliminimin e tyre në të ardhmen.

Çështja 11 - Sigurive të ekzekutimit ju kishte skaduar afati i mbulueshmërisë

E gjetura Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, neni 27, pika 6, Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas implementimit të kontratës. Në gjashtë raste², sigurive të ekzekutimit në vlerë prej 1,028,291€ ju kishte skaduar afati i vlefshmërisë edhe pse kontratat nuk ishin përfunduar.

Rreziku Skadimi i afatit të sigurimeve të ekzekutimit rrezikojnë përmbushjen e projekteve sipas kontratës.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të siguroj/ndërmerre një rishikim për të identifikuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar dhe të siguroj kontrolle adekuate që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

Çështja 12 - Planifikim jo i duhur i aktiviteteve të prokurimit dhe mangësi ne prezantimin e raportit për kontratat e realizuara

E gjetura Sipas LPP neni 8, pika 1: Jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë dhe të dorëzoj në AQP një planifikim paraprak të prokurimit, me shkrim, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson që me rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, shërbime dhe punë, të llogaritet vlera e përgjithshme e prokurimit për secilin produkt dhe karakteristikat thelbësore që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.

Gjatë vitit 2017, Zyra e prokurimit në plan të prokurimit ka paraparë që do të kontraktoj furnizime dhe shërbime në vlerë të përbashkët prej 3,964,884€, dhe punë në vlerë prej 9,477,000€. Ndërsa, në raport të kontratave të nënshkruara publike së bashku me punët shtesë, Zyra e prokurimit ka nënshkruar kontrata në vlerë prej 22,549,873€. Nuk kishte konsistencë të plotë në mes planit dhe realizimit të kontratave. Kjo kryesisht ishte si rezultat i hyrjes në obligime kontraktuale pa mbulueshmëri të mjaftueshme financiare, mos përfshirjes së projekteve kapitale të kontraktuara në 2017 në plan të prokurimit, si dhe përfshirjes dyfish të disa kontratave në raport.

² "Zgjerimi i rrugës nacionale N25.3 Segmenti Livoç Gjilan L=3.135km st.0+000.00 - 3+135.00"; "Riorganizimi i rrugës nacionale N2 - Segmenti Veternik (udhëkryqi për Gjilan) QMI Lot 2L-3883.00m", "Zgjerimi i rrugës nacionale N2, segmenti Hyrja në qytetin e Prishtinës, Loti 2", "Asfaltimi i rrugës Hamez Jashari - Kaçanik L=2284.21"; "Zgjerimi i Rrugës nacionale N25 - Segmenti Rreth rrotullimi Besi - Podujeve", dhe "Ndërtimi i rrugës Vojnik Osojan, Loti1".

Gjithashtu, testimet tona kanë hasur në projektet në vlerë prej 480,369€ të cilat nuk ishin të përfshira në plan të prokurimit, ndërsa janë kontraktuar gjatë vitit 2017, ato janë:

- “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Skivjan Novosellë, KK Gjakovë” me vlerë prej 189,334€, dhe
- “Ndërtimi i rrugës Junik Nivokaz, Komuna e Junikut” me vlerë prej 291,036€.

Ndërsa, kontratat të cilat kanë qenë të përfshira dy herë në raport të kontratave të nënshkruara janë:

- “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Skivjan Novosellë” me vlerë prej 189,334€,
- “Zgjerimi i rrugës Hyrja në qytetin e Prishtinës, loti 1 dhe 2” me vlerë të kontraktuar prej 1,374,517€,
- “Ndërtimi i udhëkryqit në fshatin Xërxe” me vlerë 189,891€, dhe
- “Asfaltimi i rrugës në Rahovë të Madhe – Mitrovicë” me vlerë të kontraktuar prej 567,880€.

Rreziku

Mos planifikimi i saktë i prokurimit mund të rrezikon arritjen e qëllimeve të Ministrisë duke shkaktuar kosto të shtesë. Po ashtu rrezikon edhe buxhetin në disponueshmëri për vitin aktual si dhe vitin e ardhshëm.

Rekomandimi 12

Ministri duhet të siguroj kontrolle adekuate dhe në bashkëpunim me zyrën e prokurimit duhet të eliminojnë parregullsitë duke mbledhur kërkesat e sakta prej çdo njësie kërkuese të organizatës në mënyrë që të gjitha procedurat e realizuara të prokurimit të jenë në përputhje me planin final. Çdo kontratë duhet të jetë e pasqyruar në raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike.

Çështja 13 - Vonesa nga hapja e ofertave deri tek vlerësimi i tyre

E gjetura

Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, neni 35 pika 2, procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve. Në 4 raste³ kemi hasur vonesa nga hapja e ofertave deri tek vlerësimi i tyre deri në 2 muaj.

³ Kontrata “Ndërtimi i udhëkryqit në fshatin Xërxe” me vlerë të kontraktuar 189,891.28€. Hapja e ofertave ka qenë më 28.07.2017, ndërsa vlerësimi i ofertave është bërë më 17.08.2017; Kontrata “Ndërtimi i rrugës Bardh i Madh – Lismir – Fushë Kosovë” me vlerë të kontraktuar prej 434,013.57€. Hapja e ofertave ka qenë më 14.08.2017, ndërsa vlerësimi i tenderit është bërë më 25.09.2017; Kontrata “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Skivjan-Novosellë, Komuna e Gjakovës” me vlerë të kontraktuar prej 189,334.16€. Hapja e ofertave ka qenë më 29.06.2017, ndërsa vlerësimi i tenderit është bërë më datën 01.08.2017; dhe Kontrata “Zgjerimi i rrugës Nacionale N2, hyrja në qytetin e Prishtinës, Loti II” me vlerë të kontraktuar prej 1,374,516.70€. Hapja e ofertave a qenë më datën 11.01.2017, ndërsa vlerësimi i tenderit ka qenë më 16.02.2017.

Rreziku Vonesa kohore nga hapja deri në vlerësimin e ofertave rrezikon procesin dhe rezulton me vonesa në implementimin e projekteve kapitale.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të siguroj mekanizma në forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit duke u aplikuar saktë afatet kohore e parapara në LPP.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 14 - Mangësi në zotimin e mjeteve dhe procesimin e urdhërbljerjeve

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-bleerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Në pesë raste në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me vlerë prej 587,227€ zotimi i mjeteve si dhe urdhër blerjet ishin proceduar pas pranimit të faturës. Këto raste kishin ndodhur tek pagesa për mirëmbajtje të rrugëve.

Më tej, në 14 raste në kategorinë e kapitaleve me vlerë prej 2,020,724€ urdhërblerjet ishin procesuar pas pranimit të faturës. Këto raste kishin ndodhur tek pagesa për asfaltime, rehabilitime dhe ndërtime të rrugëve. Gjithashtu, edhe në shtatë raste po të kësaj kategorie me vlerë prej 977,736€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat e mos monitorimit të duhur dhe mos zbatimit të rregullave të Thesarit.

Rreziku Pranimi i mallrave dhe shërbimeve para se te përcaktohen kërkesat/nevojat, e rrit rrezikun që të pranohen mallrat të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 14 Ministri së bashku me zyrën e financave duhet të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve dhe të siguroj pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPF-në dhe me rregullat e Thesari.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PFV ishte 1,274,178,142€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 177,470€ si dhe stoqet në vlerë prej 78,633€.

Çështja 15 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë të MI-së

E gjetura Sipas rregullës së MF-së, nr.02/2013 neni 22 pika 3 specifikon që të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Në MI, nga 100 raste të ekzaminuara, në 45 prej tyre kemi identifikuar që nuk është aplikuar fare zhvlerësimi për to.

Më tej, MI për vitin 2017 nuk kishte formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive dhe si rezultat i kësaj për vitin 2017 nuk kishte inventarizim dhe vlerësim të pasurive të organizatës.

Rreziku Kontrollat e dobëta në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar me mangësi në këtë komponent të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 15 Ministri, duhet t'i rishikoj kontrollat ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollat në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të evidentohen, vlerësohen dhe regjistrohen si duhet si dhe të ruhen nga humbja keqpërdorimi.

3.10 Llogaritë e arkëtueshme

Sipas PFV-ve 2017, MI ka shuma të pa arkëtuara të të hyrave në vlerë prej 184,540€. Në këtë kategori kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Obligimet e papaguara

MI, ka shpalosur obligimet e papaguara në PFV për vitin 2017 në vlerë prej 22,588,872€, ndërsa obligimet e pa paguara në fillim të vitit 2017 ishin 15,535,336€, Pjesa më e madhe e obligimeve të papaguara (15,306,323€) i takojnë Bechtel & Enka dhe kanë të bëjnë me ndërtimin e autostradës Prishtinë – Hani i Elezit. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Më tej, detyrimet kontingjente të prezantuara në PVF më 31.12.2017 janë 14,708,862€ ndërsa me 31.12.2016 ishin 14,407,675€. MI në koordinim me Avokaturën Shtetërore, është informuar për shumicën e detyrimeve/pretendimeve të pasqyruara në PFV 2017.

Në këtë kategori kemi ekzaminuar disa mostra dhe si rezultat i ekzaminimit doli që:

Çështja 16 - Rritja e obligimeve të pa paguara dhe raportime jo të plota të obligimeve

E gjetura Gjatë vitit 2017 obligimet janë rritur për 7,053,536€. Sipas zyrtarëve përgjegjës, arsye kryesore e krijimit të këtyre obligimeve ishte mungesë e buxhetit.

Pagesa dhe raportimi i obligimeve - OB, duhet që çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Gjithashtu, OB janë të obliguara që në Ministrinë e Financave të raportojnë në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara. Në dhjetë raste kemi vërejtur që faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 3,588,671€ nuk ishin paguar brenda afatit prej 30 ditësh. Më tej, në dy raste kemi vërejtur faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 1,044€ nuk ishin përfshi në raportet mujore të obligimeve.

Rreziku Rritja e obligimeve të papaguara është indikator për menaxhim jo efikas të parasë publike për vitin fiskal dhe ndikon në buxhetin e vitit vijues. Vonesat në ekzekutimin e pagesave, e rrit rrezikun për krijimin e shpenzimeve shtesë të cilat mund të rezultojnë nga ndëshkimet nga furnitorët. Gjithashtu edhe mos raportimet e obligimeve ndikojnë që organizata të mos ketë informata të plota/sakta rreth obligimeve.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të siguroj kontrolle adekuate dhe menaxhim të mirë të obligimeve, të analizoj arsyet për rritjen e tyre, obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor që të shmangen kostot shtesë, si dhe të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara bëhet në përputhje me rregullat.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016, ka rezultuar me 18 rekomandime. MI ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet zbatohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tetë rekomandime janë zbatuar plotësisht, derisa dy janë në proces të zbatimit (pjesërisht adresuar) dhe tetë nuk janë adresuar. Çështjet që janë përsëritur nga vitet e kaluara janë mangësitë në klasifikimin e shpenzimeve, mangësi në menaxhimin e pasurive, vonesat në ekzekutimin e faturave të papaguara dhe raportimin e tyre në raportet mujore në MF. Ndërsa në raportin e auditimit për vitin 2015 janë dhënë 20 rekomandime, pesë prej tyre nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 17 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Prej pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016, menaxhmenti i MI-së ka ndërmarrë masa për t'i adresuar çështjet e ngritura. Në veçanti ka progres sa i përket adresimit të rekomandimeve në fushën e llogarive të arketueshme. Megjithatë, ka mungesë të zbatimit të plotë dhe mangësi të njëjta vërehen në klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, menaxhimin e personelit dhe menaxhimin e obligimeve. Më tej, edhe rekomandimet e vitit 2015 nuk janë zbatuar plotësisht, rekomandimet e pazbatuar ndërlidhen me: klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimi i shpenzimeve dhe pasurive, menaxhimi i rrezikut dhe raportimi i obligimeve.

Rreziku Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e dobësive të identifikuarra, dhe si rezultat në vazhdimësi kemi përsëritjen e mangësive të njëjta.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk implementohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktivë ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në MI në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien pasqyron një situatë pozitive. Megjithatë edhe me tutje janë të nevojshme të behën përmirësime. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm ishte jo i duhur, një pjesë të rekomandimeve ishte zbatuar dhe është në proces të zbatimit të rekomandimeve tjera. Më tej MI, edhe pse gjatë viteve të mëhershme nuk kishte të ndërtuar sistemin për menaxhimin e rreziqeve por në fillim të vitit 2018 ka treguar progres në këtë drejtim duke hartuar raportin e rreziqeve, ku është edhe menaxhimi i tyre.

Ne duhet të theksojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në vazhdimësi tregon një cilësi të mirë të punës përmes së cilës jep vlerësime të qëndrueshme lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsiderate nga menaxhmenti i MI-së për përmirësimin e fushave me mangësi të theksuara.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. MI ka arritur të realizoj rreth 98.27% buxhetin final për vitin 2017.

Më tutje, përforma e menaxhimit të shpenzimeve përveç keqklasifikimeve në kategorinë e kapitaleve, këtë vit është përmirësuar edhe më tej në raport me vitet tjera. Megjithatë në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshinë kryesisht prokurimin, menaxhimin e pasurive dhe menaxhimin e obligimeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MI ka njësinë e auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi e cila përbëhet nga drejtori i njësisë së auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe tre auditor.

Njësia e auditimit të brendshëm për 2017 ka planifikuar nëntë auditime si dhe katër auditime me kërkesë. Në vitin 2017, kjo njësi ka realizuar 13 auditime. MI kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe është në proces në implementimin e tyre. Gjithashtu NJAB ka përgatitur raporte tremujore për aktivitetet e saj në NJQHAB në MF.

Çështja 18 - Mos mbulueshmëria e periudhës aktuale me auditime nga NjAB

E gjetura Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB-së janë mira dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm. Megjithatë, auditimet e finalizuara nuk kishin mbuluar aktivitetet e vitit aktual, por kryesisht ishin fokusuar në aktivitetet e vitit 2016.

Rreziku Mos mbulueshmëria e periudhës aktuale me auditime nga NjAB zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë me humbje financiare për Ministrinë e Infrastrukturës.

Rekomandimi 18 Ministri, në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, duhet të rishikojnë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në proceset e vitit aktual dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti i MI-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e saj.

Më tej, të gjitha organizatat buxhetore pritet që të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Dispozitat ligjore përcaktojnë që organizata është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

Çështja 19 - Menaxhimi i rrezikut

- E gjetura** MI gjatë 2017 nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve. Për këtë arsye ne nuk kemi mundur të vlerësojmë identifikimin e të gjitha rreziqeve domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Megjithatë, në fillim të vitit 2018, MI kishte ndërmarrë masa duke hartuar raportin e rreziqeve duke përfshirë edhe menaxhimin e tyre, raport ky i cili do të vlerësohet në auditimin e vitit 2018.
- Rreziku** Mos përgatitja e regjistrit të rreziqeve ndikon që menaxhmenti të mos identifikojë dhe të menaxhojë rreziqet të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 19** Ministri duhet të ndërmerr masat e duhura për identifikimin e vazhdueshëm të të gjitha rreziqeve domethënëse si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të organizatës.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.2 Opinioni i auditimit	<p>Çështja 1 – Menaxhimi i shpenzimeve dhe pasurisë</p> <p>Prioritet i Lartë – Ministri duhet të konsideroj çështjen e shpenzimeve lidhur me mirëmbajtjen investive të rrugëve, dhe të analizoj çështjen me rastin e ndarjeve buxhetore me qëllim që të mundësohet një ndarje e drejtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike. Në anën tjetër të siguroj se është duke u zbatuar një proces i cili do të mundësonte evidentimin e plotë të pasurisë në regjistrat e saj dhe siguron vlerësim të drejtë të pasurisë në PVF 2016. Ky proces duhet të përmirësoj trajtimet kontabël lidhur me bashkëfinancimet dhe të siguroj se çdo lëvizje apo shpërndarje e pasurisë të jetë saktësisht e dokumentuar. Të gjitha projektet kapitale të financuara nga Ministria si bashkë financuese të vazhdojnë të evidentohen si investime në vijim, të shoqëruar me një plan me detajet dhe datat e transferit, përfituesit, kostos, etj. Po ashtu, të sigurohet se menaxhimi i stoqeve të kripës ka raporte të sakta mbi furnizimin dhe shpërndarjen e saj. Ky proces duhet të përcaktoj saktë bilancin për sasinë dhe vlerën në fund të vitit.</p>			Nuk është zbatuar.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	<p>Çështja 3 –Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.</p>			Nuk është zbatuar.

2.5.2 Vlerësimi i rrezikut	Çështja 6 - Kërkesa për menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk është zbatuar.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Çështja 9 - Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve në kodet ekonomike- Prioriteti i mesëm Ministri duhet të sigurojë që gjatë procesit të buxhetimit shpenzimet e buxhetuara të klasifikohen sipas planit kontabël.			Nuk është zbatuar.
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Çështja 20 - Raportimi jo i plotë i obligimeve - Prioritet i lartë Ministri duhet të siguroj se do të rishikohet i tërë procesi i pranimi dhe përcjelljes së faturave për pagesë në mënyrë që të mundësojë menaxhim të drejtë dhe të mbështesë raportimin e plotë të obligimeve të papaguara.			Nuk është zbatuar.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.1 Opinioni i auditimit	Çështja 1 - Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e mirëfilltë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i shmangur gabimet në klasifikimin e shpenzimeve, vlerësimin e pasurive dhe për të siguruar prezantim të drejtë të PVF-ve;			Nuk është zbatuar.

<p>1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim</p>	<p>Çështja 2 - Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe kërkesat për raportim të jashtëm. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	<p>Është zbatuar</p>		
<p>2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak</p>	<p>Çështja 3 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara.</p>		<p>Ka mungesë të implementimit të plotë dhe mangësi të njëjta vërehen në klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, menaxhimin e personelit dhe menaxhimin e obligimeve</p>	
<p>2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së</p>	<p>Çështja 4 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë Ministri duhet të sigurojë se është analizuar plotësisht i pyetësit të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Rëndësi e veçante t'i kushtohet avancimit të mëtutjeshëm të procesit të menaxhimit të rrezikut, përfshirë tij aspektet tjera të fushë veprimtarisë së ministrisë.</p>	<p>Është zbatuar</p>		

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	<p>Çështja 5 - Mungesa e planit strategjik të Ministrisë - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet të ndërmarrë hapa konkret drejt procesit të hartimit të planit strategjik dhe vendosjes se objektivave të ministrisë, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.</p>	Është zbatuar		
2.3.2 Raportimi menaxherial	<p>Çështja 6 - Dobësi në raportimin menaxherial - Prioriteti i lartë</p> <p>Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të vendosur një format të përshtatshëm të raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, si dhe ngritjen e cilësisë së informacionit që pranojnë për të mbështetur menaxhimin efektiv të veprimtarisë së ministrisë.</p>	Është zbatuar		
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	<p>Çështja 7 - Sistemi i Auditimit të Brendshëm - Prioriteti i lartë</p> <p>Ministri duhet të sigurojë se plani vjetor i auditimit është më gjithëpërfshirës, i bazuar në rrezik, dhe implementohet në tërësi nga NjAB. KA duhet të jetë më objektiv, të sigurohet se përbërja e anëtarëve të komitetit të mos përfshijë personel që janë të angazhuar në punët ekzekutive nga fusha e buxhetit dhe financave. Gjithashtu të rishikohen veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.</p>	Është zbatuar		
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	<p>Çështja 8 - Realizim jo i mirë i buxhetit për investime kapitale - Prioriteti i lartë</p> <p>Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.</p>	Është zbatuar		

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	<p>Çështja 9 - Tejkalimet e afateve të përcaktuara kohore për marrëveshjet për shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm</p> <p>Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për ta adresuar, si çështje urgjente, angazhimin e punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta. Kjo formë e kontraktimit të bëhet vetëm në raste të veçanta dhe të arsyeshme për nga aspekti kohor dhe i nevojave të angazhimit.</p> <p>Çështja 10 - Dobësi në menaxhimin e personelit - Prioritet i mesëm</p> <p>Ministri duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante për shërbimin civil. Po ashtu për pozitat me UD duhet të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme në pajtim me kornizën ligjore.</p>			<p>Nuk është zbatuar.</p> <p>Nuk është zbatuar.</p>
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	<p>Çështja 11 - Dobësi në procedurat e prokurimit - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim gjithëpërfshirës për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit publik nuk janë zbatuar në tërësi. Kontrollat e brendshme në këtë fushë duhet të jenë subjekt i rishikimit urgjent nga menaxhmenti. Në prokurimet e radhës duhet të aplikohen kontrole efektive që sigurojnë pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore në të gjitha fazat e procesit të prokurimit.</p> <p>Çështja 12 - Dobësi në menaxhimin e kontratave - Prioritet i mesëm</p> <p>Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim rreth dobësive të identifikuara, si dhe të analizojë pse nuk është aplikuar mbikëqyrja efektive e menaxhimit të kontratave. Kontrollat duhet të forcohen për të siguruar që menaxhimi i kontratave zhvillohet sipas kërkesave dhe udhëzuesve përkatëse.</p>			<p>Nuk është zbatuar.</p> <p>Nuk është zbatuar.</p>

3.1.4 Subvencionet dhe transferet	<p>Çështja 13 – Vonesa në vlerësimin e ofertave - Prioritet i mesëm</p> <p>Ministri duhet t'i analizojë arsyet e dështimit të kontrolleve dhe të identifikojë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e projekteve. Një dizajn i kontrolleve efektive, në pajtueshmëri të plotë me rregulloret, duhet të sigurohet dhe të monitorohet në mënyrë sistematike nga ana e menaxhmentit.</p>	Është zbatuar		
3.1.5 Investimet kapitale	<p>Çështja 14 – Menaxhimi i projekteve kapitale - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuara me qëllim të arritjes së objektivave të ministrisë brenda afateve kohore. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.</p> <p>Çështja 15 – Dobësitë në prokurim - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri i duhet t'i analizojë arsyet e papajtueshmërive të identifikuara dhe t'i forcojë kontrollet e prokurimit për të siguruar që të gjitha kërkesat ligjore do të përmbushen. Vetëm operatorët që përmbushin në tërësi kërkesat e përcaktuara duhet të shpërblehen me kontratë për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret dhe vlerë të duhur për paratë e shpenzuar .</p>			<p>Nuk është zbatuar.</p> <p>Nuk është zbatuar.</p>

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	<p>Çështja 16 - Mos ofrimi i informatave të plota për auditim - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet t'i rishikojë proceset e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve dhe t'i identifikojë arsyet për mos ofrimin e informatave të plota për auditim. Ministri duhet t'i përforcojë mekanizmat e kontrollit dhe të kërkojë llogaridhënie nga zyrtarët e prokurimit për të siguruar që situatat e tilla mos të përsëriten në ardhmen.</p>		Ka progres krahasuar me vitet e kaluar lidhur me ofrimin e dokumentacionit, në këtë kuptim janë ofruar në përgjithësi dokumentacioni, përveç të një oferte e cila ka munguar dhe nuk është ofruar	
3.2.2 Të arkëtueshmet	<p>Çështja 17 - Menaxhim jo i mirë i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet t'i identifikojë barrierat në inkasimin e të arkëtueshmeve dhe të sigurojë mekanizma efektive, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar se faturat e debitorëve janë paguar apo janë duke u adresuar. Krahas kësaj, duhet të vendosen kontrolle efektive për të parandaluar ngritjen e mëtuajtshme të këtyre llogarive.</p>	Është zbatuar		
3.3 Obligimet e papaguara	<p>Çështja 18 - Menaxhimi jo i mirë i obligimeve - Prioritet i lartë</p> <p>Ministri duhet t'i forcojë kontrollet menaxheriale duke siguruar një planifikim të hollësishëm të buxhetit dhe shfrytëzim të fondeve të bazuar në një plan të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Ministri poashtu duhet të paraqes një plan ku parashihet buxheti dhe veprimet konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të akumuluar. Ky plan duhet të monitorohet direkt nga menaxhmenti. Në anën tjetër, të gjitha obligimet duhet të raportohen me kohë në MF/Thesar.</p>			Nuk është zbatuar.

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
27.06.2018			
Numri i Protokollit Prot. No.	Kodi i Klasifikimit Class. Code	Nr. i Fajveve Br. Stranica	Nr. i Stranica No. Pages
03	47	1197	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE			
Mbështetja e Org. Ndihmës Org. Unit	04	Nr. i Protokollit Prot. No.	6163
Nr. i Fajveve No. Pages	01	Data Date	27.06.18
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Infrastrukturës
 Ministarstvo Infrastrukture
 Ministry of Infrastructure

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


 Nebih Shatri
 Sekretar i Përgjithshëm

Data: 27 qershor 2018, Prishtinë,